



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1242/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Vehbi Eminit – Kandidatë për Asamble Komunale (LDK) dega në Ferizaj, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak të mungesës së votave, të zgjedhjeve lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat: Anr.1242, Anr.1243, Anr.1244, Anr.1245, Anr.1246 Anr.1247, Anr.1256, të datës 03.12.2013, të Vehbi Eminit – Kandidatë për Asamble Komunale (LDK) dega në Ferizaj.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar ankesat: Anr. 1242 Anr.1243, Anr.1244, Anr.1245, Anr.1246 Anr.1247, Anr.1256 të datës 03.12.2013, të të Vehbi Eminit – Kandidatë për Asamble Komunale (LDK) dega në Ferizaj, në të cilat ankesa pretendon se dyshon se ka pasur keqpërdorime dhe mungesë të votave.

- Në ankesën Anr.1242/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në VV 2501d/06R, QV 25017/01R, QV2502D/04R kërkoi që të rihapen dhe rinumërohen votat.
- Në ankesën Anr.1243/13 të datës 03.12.2013, ka pretenduar se në QV2516/01R sipas informatave i kamë 6 vota ndërsa sipas KQZ-së janë të prezantuara vetëm 3, prandaj kërkoi që të rihapet i njëjti QV për verifikim.
- Në ankesën Anr.1244/13 të datës 03.12.2013, ka pretenduar se në në fsh. Dragash në QV2523D/03R kamë informata nga familjarët se i kamë 5 vota ndërsa sipas KQZ-së është vetëm 1 votë, prandaj kërkoi verifikimin e VV.
- Në ankesën Anr.1245 /13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në QV2501D/01R sipas informatave e kamë 1 votë ndërsa sipas KQZZ-së nuk kamë vota. Më tutje ka theksuar se në QV2507D/04R sipas informatave i kamë 9 vota ndërsa sipas KQZ-së janë vetëm 3 vota, prandaj kërkoi që të rihapen dhe verifikohen votat.

- Në ankesën Anr.1246 /13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në QV.2509D/02 sipas informatave të votuesve të afërm i kamë 5 vota sipas KQZ-së figuron 1 votë. Më tutja ka theksuar në QV 2509D/03 duhet të jenë 9 vota sipas KQZ-së janë vetëm 2, prandaj kërkoi që të rinumërohen votat.
- Në ankesën Anr.1247/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në QV 2503D/03R, sipas KQZ-së i kamë pasur 5 vota prandaj kërkoi që të rihapet dhe rinumërohen votat. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një regjistër të numërit të votave për kandidatër Asamble Komunale.
- Në ankesën Anr.1256/13 të datës 03.12.2013 , pretendohet se, në VV nr. 2501D/06R, 2501Y/01R në këto të njëjtat VV më mungojnë votat e premtuara, prandaj kërkoi që të rinumërohen kërkoi votat.

Bazuar në nenin 6.3 të “Rregullave dhe Procedurave” të PZAP-it, në të cilin parashihet se: “Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, Kryesuesi i Panelit mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, paneli vendim-marrës i trajton ato ankesa sikurse të ishin një ankesë”. Në rastin konkret Kryesuesi i Panelit duke u bazuar në dispozitën ligjore të lartcekur ka vendosur ti bashkoi ankesat e sipërshënuara dhe ti trajtoi si një ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesat gjeti se:

Ankesat janë të pa bazuara

Pretendimet ankimore nga ana e Vehbi Eminit – Kandidatë për Asamble Komunale (LDK) dega në Ferizaj, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) , ku dyshohet për pa rregullsi dhe keqpërdorime si dhe munges të konsiderueshme të votave nëpër QV, mirëpo nuk është ofruar asnjë provë relevante nga ana e palës ankuese, me të cilat do të mund të vërtetoheshin shkeljet e supozuara.

Prandaj për shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar se kanë ndodhur dhe janë evidentuar pa rregullsi dhe keqpërdorime gjatë procesit të votimit në QV,të lartcekura nga parashtruesi i ankesës, PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore janë të përgjithshme dhe të pa qarta për tu vërtetuar dhe ankesat e lartpërmendura u refuzuan si të pa bazuara, prandaj duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesat e lartë përmendura u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 1242/2013 më datën 06.12.2013

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**

M. Shala

Këshillë juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.

